



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 18  
27.05.2015

NR. VENDIMI 20  
15.09.2015

**VENDIM**

**“Ne emer te Republikes”**

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane  
me trup gjykues te perbere prej gjyqtareve:

**Kryesuese** : Iliriana OLLDASHI  
**Anetar** : Ardit MUSTAJ  
**Anetar** : Idriz MULKURTI

Asistuar nga sekretare gjyqesore **Alma Ramaj**, ne Tirane, sot, me date **15/09/2015, ora 11:32** mori ne shqyrtim, ne seance gjyqesore publike, kerkese-padine qe ju perket paleve:

**Padites:** Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda, perfaqesuar ne gjykim nga prokurori **Gentian Trenova**.

**E paditur:** **Z. C.**, e bija e S.dhe e S., e datelindjes xxxx, lindur dhe banuese ne xxxx, Lagjia “xxxx”, Rruga “xxxx”, Nr.xx.  
**Perfaqesuar ne gjykimin e kesaj kerkese-padie nga perfaqesuesit e zgjedhur me deklarim ne gjykim, av. A. V., anetar i Dhomes se Avokatise xxxx, me nr. License profesionale xxxx dhe av. A. P., anetar i Dhomes se Avokatise xxxx, me nr. License profesionale xxxx.**

**Me objekt:** Konfiskimin e pasurise se te paditures Z. C., vleres monetare prej xxxx (xxxx) leke e ndodhur ne llogarine bankare me nr. xxxx, te Bankes xxxx, xxxx ne emer te te paditures.

**Baza ligjore:** **Ligji nr. 10192 date 03/12/2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”, nenet 21, 23, 24 te tij.**

**Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te zhvilluar ne prani te:**

**Pales Paditese Prokuroria per Krime te Renda, qe nepermjet perfaqesuesit, prokurorit Gentian Trenova kerkoi:**

- Konfiskimin e pasurise, vleres monetare prej xxxx (xxxx) leke e ndodhur ne llogarine bankare me nr. xxxx, te Bankes xxxx, Sporteli Shkoder ne emer te te paditures Z. C..
- Heqjen dore nga gjykimi i kerkimit te konfiskimit te vleres monetare prej xxxx (xxxx) leke.
- Per ekzekutimin e ketij vendimi te ngarkohen Zyrtar e Permbartimit Gjyqesor te Rrethit xxxx, ndersa per administrimin dhe perdorimin e pasurise te ngarkohet Znj. E. O. (P.), Administratore prane Agjencise per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

**Perfaqesuesit te te paditures Z. C., av. A. V. qe kerkoi:**

- Rrezimin e kerkeses per konfiskim te prokurorise si te pabazuar ne ligj e ne prova dhe heqjen e sekuestros ndaj llogarise se te paditures Z. C..

**kjo gjykate pasi degjoi kerkimet e paleve ndergjyqese dhe shqyrtoi provat e ketij gjykimi :**

## V E R E N s e

Prokuroria per Krime te Renda ka paraqitur para kesaj gjykate kerkese-padine me objekt konfiskimin e pasurise se te paditures Z. C. qe konkretisht ishte vlera monetare prej xxxx (xxxx) leke e ndodhur ne llogarine bankare me nr. xxxx, te Bankes xxxx ne emer te te paditures.

Kerkese-padia per konfiskimin e kesaj pasurive eshte bere nga pala paditese, Prokuroria per Krime te Renda mbi pretendimin se ka dyshime te arsyeshme, bazuar ne indicie, per pjesemarrjen e djalit te te paditures, shtetasit Y. C. ne veprimtari kriminale te parashikuar ne nenin 3 te ligjit nr. 10 192, date 03/12/2009 dhe pasuria objekt i ketij gjykimi ne emer te te paditures Z. C. te ardhurat prej xxxx lekesh te investuara ne bono thesari, ne Banken xxxx jane krijuar pas aktivitetit kriminal qe korrespondon ne periudhen e muajit nentor te vitit 2011 dhe nuk i pergjigjen dukshem nivelit te te ardhurave apo fitimeve te ligjshme dhe si te tilla nuk justifikohen prej saj.

Kjo kerkese-padi konfiskimi eshte paraqitur ne date xxxx nga pala paditese Prokuroria per Krime te Renda brenda afatit 6 mujor, pas perfundimit te procedurave gjyqesore per sekuestrimin e kesaj pasurie, ne zbatim te nenit 12 te ligjit nr. 10192, date 03/12/2009.

Perfaqesuesi i te paditures Z. C., **av. A. V.** e kundershtoi konfiskimin e pasurise, vleres monetare ne emer te te mbrojtues prej tij duke pretenduar ligjshmerine e prejardhjes dhe justifikimin e saj me te ardhurat e ligjshme te perfutuara nga kursimet e saj dhe te familjareve te saj (pa lidhje me te dyshuarin Y. C.).

### **Nga shqyrtimi i provave te ketij gjykimi rezultuan te provuara keto fakte:**

Fillimisht Prokuroria per Krime te Renda ka regjistruar procedimin pasuror nr.xx te vitit xxxx ne emer te shtetases Z. C..

Ne date xxxx nga ana e Prokurorise Prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda eshte rregjistruar referimi pasuror me nr xx.

Ky rregjistrim eshte bere pasi nga Ministria e Drejtesise me shkresen me nr. xxxx Prot date xxxx i ka dhene rruge kerkeses per ndihme

juridike te ardhur nga autoritet gjyqesore te drejtesise se shtetit te francez.

Kjo kerkese eshte percjelle me shkresen me nr. xxxx prot, date xxxx te Prokurorise se Pergjithshme.

Kerkesa per ndihme juridike eshte bere nga ana e Gjykates se Apelit , Bordo, France, date xxxx, ne kuadrin e ceshtjes penale ndaj shtetasve Y. C., A. Rr. etj.

Nepermjet kerkeses per ndihme juridike behet e njohur se autoritetet perkatese te shtetit te Frances dhe konkrestisht te policise qe i perkasin rrethit gjyqesor Perige kane nisur hetimet qe nga muaji nentor te vitit 2011 ndaj nje grupi personash te cilet merreshin me trafikim dhe shperndarje te lendeve narkotike. Hetimet kane vazhduar edhe gjate vitit 2012 dhe vitit 2013.

Ne date 8 dhe 9 qeshor te vitit 2013 nga nje aksion per kontrollin e lokaleve te nates, qe kishin lidhje me trafikun e lendeve narkotike u arrestuan 26 persona dhe u bene kontrolle ambientesh e personash qe u shoqeruan edhe me sekuestrime te lendeve narkotike, kanabis, kokaine dhe arme.

Ne kete ceshtje penale hetohen per trafikim dhe shperndarje te lendeve narkotike edhe shtetasit shqiptar A. Rr. dhe Y. C.. Gjate arrestimit te shtetasit Y. C. ne kontrollin e baneses jane gjetur edhe shenime te shumta te cilat tregojne per para. Ne lidhje me keto i arrestuari ka deklaruar se ato kane lidhje me llogarite e aktiviteve tregtare ne Shqiperi.

Vepra penale per te cilen hetohet shtetasi Y. C. parashikohet edhe ne dispozitat penale te Republikes se Shqiperise nga nenet 283 dhe 283/a te Kodit Penal.

Ne aktet e percjella nepemjet leterporosise se autoriteteve franceze eshte pasqyruar fakti se hetimet ne lidhje me aktivitetin kriminal te provuar ndaj shtetasit Y. C. etj. rezultojne te kene ndodhur ne periudhen **nentor 2011 deri ne vitin 2013**.

Sipas autoriteteve franceze i dyshuari ka gjeneralitet: Y. C., i biri i H. dhe i Z., i datelindjes xxxx, lindur ne xxxx.

### **Rrethanat e faktit:**

Ne lidhje me ceshtjen penale ne ngarkim te tij shtetasi Y. C. ka deklaruar se ai jeton ne Perige te Frances me gruan dhe dy femijet e tij.

Jeton ne France me ndihmen sociale si dhe me te ardhurat qe vijne nga Shqiperia nga bizneset ne Shqiperi. Ne Shqiperi ka nje dyqan Fast, food dhe nje qyqan rrobash. Me menaxhimin e tyre merret kusherira e quajtur Xh. D.. Ka dy shtepi nje ne xxxx ne xxxx dhe shtepia tjeter ne lagjen xxxx

ne xxxx. Nga fitimet e biznesit ne Shqiperi i dergohen ne France ne menyra te ndryshme rreth xxxx euro ne muaj . keto para jane derguar nga familjare e tij A. B. dhe nga menaxherja e biznesit ne Shqiperi.

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda me vendimin nr. xxxx date xxxx ka lejuar ekzekutimin e kerkeses per ndihme juridike te autoriteteve te shtetit te Frances.

Bazuar ne te dhenat e kerkeses per ndihme juridike eshte sugjeruar dhe kane filluar kryesisht kryerja e verifikimeve paraprake per pasurite e shtetasve Y. C. e A. Rr..

Nga pergjigjet e marra ne institucionet bankare ne Shqiperi rezulton se: me shkresen me nr xxxx prot date xxxx nga ana e Bankes xxxx provohet fakti se shtetesja Z. C., e ema e shtetasit Y. C. ka investuar ne bono thesari.

Gjendja aktuale ne banke ka qene ne shumen xxxx leke.

Kjo shume eshte investuar ne bono thesari ne muajin korrik te vitit xxxx ne shumen prej xxxx leke, dhe ne muajin shtator te vitit xxxx ne shumen xxxx leke.

Per sa me siper ne baze te ligjit ligjit nr.10192 date 03.12.2009 “Per parandalimin dhe goditjen e krimet te organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise”, me kerkese te Prokurorise, Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda, Tirane me vendimin **nr. xx, date xxxx** ka lejuar sekuestrimin e llogarise bankare, ne Sportelin xxxx te Bankes xxxx me nr. xxxx ne emer te shtetases Z. C. me vlere nominale xxxx ( xxxx) leke.

Vendimi i mesiperm i Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda eshte ekzekutuar ne date **xxxx** per llogarine ne Banken e xxxx, Sporteli xxxx per vleren nominale prej xxxx (xxxx) leke e cila eshte gjendur ne momentin e ekzekutimit te saj. Ky fakt konfirmohet me aktet Shkresen nr. xxxx, date xxxx te Bankes Qendrore te Republikes se Shqiperise, si dhe Procesverbaline date xxxx per ekzekutimin e vendimit nr. Nr xxx, **date xxxx**, Gjykata e Shkalles se pare per Krime te Renda.

Qe ne fillim te gjykimit, pala paditese, Prokuroria per Krime te Renda, nepermjet perfaqesuesit te saj, prokurorit Trenova paraqiti aktin shkresor **nr.xxx prot.,date xxxx** te Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara, Ministria e Financave, ne permbajtje te se ciles pasqyrohet fakti, se nga verifikimet e bera nga kjo agjenci ne momentin e ekzekutimit te

vendimit per sekuestrimin e shumes monetare te ndodhur ne llogarine bankare me nr. xxxx, ne Banken xxxx, Sporteli xxxx ne emer te te paditures Z. C. ka rezultuar se **shuma reale e gjendur ne kete llogari ka qene xxxx leke dhe jo xxxx** qe kerkohej te sekuestrohej sipas vendimit gjyqesor dhe per kete shume eshte bere sekuestrimi i saj.

Paraqitjen e ketij akti pala paditese nuk e shoqeroi as me sqarime te tjera per paraqitjen e tij dhe as me ndryshime ne objektin e kerkimit te saj, megjithë insistimin deri ne pengim te ecurise normale te procesit gjyqesor te perfaqesuesit te pales se paditur per zvogelimin e objektit te padise (**shih procesverbalin e seances gjyqesore te dates dhe rregjistrimin audio te saj**).

### **Vleresimi i Gjykates.**

Kjo gjykate, **duke pare parashikimet e neneve 21-23 e posaçerisht kriteret e percaktuara ne nenin 24 te ligjit parandalues nr. 10 192 date 03/12/2009**, mbeshtetur ne provat e shqyrtuara dhe debatuar ne seance gjyqesore, **vlereson se** mbi bazen e akteve, e provave te derguara nga autoritetet e drejtesise se shtetit francez rezulton se shqiptar Y. C. hetohet per veprat penale te parashikuara nga nenet **283 dhe 283/a** te Kodit Penal shqiptar.

Pra **se pari**, ashtu si edhe ne fazen e sekuestrimit te kesaj pasurie edhe kjo gjykate e gjen te drejte pretendimin e akuzes, se nisur nga lloji i veprave penale per te cilat hetohet ky shtetas dhe ekzistenca e dyshimit te arsyeshem te bazuar (tek indicjet), tek provat ne rastin konkret, se shtetasi Y. C. eshte i perfshire ne nje veprimtari kriminale te trafikimit dhe shperndarjeve te lendeve narkotike ne periudhen **nentor 2011 deri ne vitin 2013**, ai eshte subjekt ndaj pasurive te te cilit zbatohen dispozitat e ligjit **nr. 10192, date 03/12/2009** “Per Parandalimin dhe Goditjen e Kriminimit te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise”, sipas parashikimit **te nenit 3/1 pika ç** te ketij ligji. Po ashtu edhe nena e tij, shtetasja Z. C. eshte subjekt i hetimit pasuror sipas parashikimit **te paragrafit te dyte te nenit 3**, germa “a” te ligjit parandalues .

**Se dyti** : Gjykata vlereson se ligji parandalues, ne baze te nenit 3/2 te tij, vepron edhe ndaj pasurive qe gjenden ne zoterim te personave te aferm te familjes se te dyshuarit Y. C., **me kushtin qe pasuria ne emer te tyre te jete vene, te jete krijuar, ne kohen e perfshirjes se te denuarit ne**

veprimtarine kriminale per te cilen dyshohet se ka kryer, kusht i cili parashikohet nga neni 3/4 i ketij ligji.

**Se treti:** Nga aktet e provat e sjella prej vete pala paditese, Prokurorise per Krime te Renda ne kete gjykim (pasi pala e paditur refuzoi te paraqiste prova edhe mbi sqarimet ekstra-proceduriale te kesaj gjykate mbi rregullat dhe momentin procedural te paraqitjes se provave), konkretisht te shkreses **nr. xxxx Prot, date xxxx te Bankes xxxx dhe raportit nr.xxxx, date xxxx** qe shoqeron ate, provohet se **pasuria objekt konfiskimi eshte krijuar nga viti 2004-2008, pra para nentorit te vitit 2011**, e rrjedhimisht eshte pasuri e krijuar **para** periudhes kur provohet se i dyshuari Y. C., personi i lidhur me te padituren Z. C., ka qene i perfshire ne veprimtari kriminale te shperndarjes dhe trafikimit te lendeve narkotike per te cilen hetohet.

Ne keto kushte e gjithë pasuria objekt i kerkeses per gjykim, nuk perfshihet ne pasurite qe duhet t'i nenshtrohet rregullave te parashikuara ne ligjin parandalues sipas parashikimit te nenit 3/4 te ligjit parandalues duke perjashtuar keshtu edhe te padituren Z. C. nga barra e proves per te justifikuar ligjshmerine e krijimit te kesaj pasurie.

Keshtu nga analiza vetem nepermjet kqyrjes se dokumentit konkretisht te shkreses nr. xxxx Prot, date xxxx te Bankes xxxx dhe raportit nr.xxxx, date xxxx qe shoqeron ate rezulton se disa nga shumat monetare ne emer te te paditures Z. C. te cilat jane perdorur per te blere bono thesari kane qene:

Ne daten xxxx	shuma	xxxx leke	per afatin 6 mujor.
Ne daten xxxx	shuma	xxxx leke	per afatin 1 vjeçar.
Ne daten xxxx	shuma	xxxx leke	per afatin 1 vjeçar.

Kjo levizje e shumave monetare ne emer te te paditures Z. C. dhe blerja e bonve te thesarit prej saj ka vazhduar edhe ne vitet 2006,2007 dhe vetem ne vitin 2008 ka investuar ne bono thesari shumen monetare **prej xxxx leke**, pra me teper sesa vlere qe pala paditese i kerkon te justifikojte ne **vitin 2011-2013**.

Vetem me pasqyren e levizjeve bankare te shumave monetare te sjella nga pala paditese ne gjykim automatikisht e paditura Z. C. ndodhet ne pozicionin komod te justifikimit te te ardhurave qe kerkohet t'i konfiskohen.

Kjo gjykate konstaton se vlere prej xxxx lekesh e kerkuar ne fillim te ketij gjykimi **nuk ka qene nje vlere inekzistete siç pretendon mbrojtja e te paditures C.**, pasi pasqyrat e levizjeve bankare pasqyrojne edhe me teper te

ardhura se kjo shume, te cilat e paditura i ka investuar dhe perfituar (duke perfshire edhe interesat), por edhe vlera fillestare e kerkuar nga pala paditese (dhuma prej xxxx leke) justifikohet me periudhen kohore se kur e paditura i ka zoteruar keto te ardhura, pra para perfshirjes se te birit, Y. C. ne veprimtari kriminale.

Per vleren nominale prej xxxx lekesh per shkak se nuk ishin realisht ne momentin e sekuestrimit te parave qe gjendeshin ne llogarine bankare, pala paditese hoqi dore nga gjykimi i kerkimit te tyre.

Ne baze te neneve **201 dhe 299/b** te Kodit te procedures civile per shkak te heqjes dore nga gjykimi i ketij kerkimi, kjo gjykate vendosi pushimin e gjykimit te kerkimit te Prokurorise per Krime te Renda ne lidhje me konfiskimin e vleres nominale prej xxxx lekesh ne emer te te paditures Z. C..

**Perfundimisht**, mbeshtetur ne provat shkresore te marra ne kete gjykim te sjelle nga vete pala ndergjyqese qe ka iniciuar procesin Prokuroria Per Krime te Renda **vlera e pasurise qe akuza kerkon te konfiskoje, justifikohet**, prandaj **Gjykata vlereson se nuk plotesohen kriteret e percaktuara ne nenin 24/1 pika “b” te ligjit 10 192 date 03.12.2009, prandaj kerkesa per konfiskim duhet te rrezohet si e pabazuar.**

Lidhur me masen e sekuestratos se vendosur mbi pasurite e cituara me siper ne kushtet kur prokurori heq dore nga gjykimi i nje kerkimi dhe gjykata rrezon kerkesen per konfiskim te shumave monetare ne emer te te paditures Z. C. pushojne dhe efektet e sekuestrimit te tyre, ne kuptim te nenit **12/5** te ligjit **nr.10192 date 03.12.2009** “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise” .

Per kete arsye kjo gjykate vendos revokimin e mases se sekuestratos se vendosur mbi kete pasuri me vendimin **nr. xxx, date xxxx te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane.**

Per ekzekutimin e ketij vendimi, ne perputhje me nenin 14 te Kodit te procedures civile, urdherohet Zyra e Permbarrimit Gjyqesor xxxx dhe znj.E. O. (P.), administratore prane Agjencise per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara ne Ministrine e Financave.

Shpenzimet gjyqesore ne baze te nenit 25/4 te ligjit 10192 date 03/12/2009, mbeten ne ngarkim te shtetit.

Mbi arsyetimin e pasqyruar me siper ne baze te nenit 212 e vijues te



Kodit te Procedures Civile dhe neneve 24 e vijues te ligjit **nr. 10192, date 03/12/2009** “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”, kjo gjykate pasi formoi bindjen dhe ne mbeshtetje te provave te shqyrtuara ne kete gjykim:

### **V E N D O S I**

1. Rrezimin e kerkese-padise se Prokurorise prane Gjykates per Krime te Renda per konfiskimin e pasurise prej xxxx (xxxx) leke te ndodhura ne llogarine bankare me nr. xxxx, ne Sportelin xxxx te Bankes xxxx ne emer te te paditures Z. C..
2. Pushimin e gjykimit te kerkimit te Prokurorise per Krime te Renda ne lidhje me konfiskimin e vleres nominale prej xxxx (xxxx) leke ne emer te te paditures Z. C..
3. Revokimin e mases se sekuestros se vendosur mbi kete pasuri, vleres monetare prej xxx (xxxx) leke e ndodhur ne llogarine bankare me nr. xxxx, te Bankes xxxx, Sporteli xxxx ne emer te te paditures, me vendimin nr. xx, date xxxx te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane.
4. Per ekzekutimin e ketij vendimi te ngarkohen Zyrat e Permbarimit Gjyqesor e Rrethit Tirane, dhe Agjensia per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane, perfaqesuar nga administratorja Znj. E. O. (P.), brenda 15 diteve nga njoftimi i tyre.
5. Urdherohet sekretaria gjyqesore te njoftoje kopjen e ketij vendimi Agjensise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane, si dhe te Zyres se Permbarimit Gjyqesor Tirane. Shpenzimet gjyqesore siç jane bere.
6. Kunder ketij vendimi lejohet ankim, brenda afatit ligjor, ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda Tirane.

**U shpall ne Tirane, me date 15/09/2015, ora 12:12.**

**SEKTETARE**

**Alma RAMAJ**

**GJYQTARE**

**Iliriana OLLDASHI**









